



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 31, datë 17.03.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“STRUKTURË SHËRBIMI DHE HOTELERIE 1 DHE 4 KATE ME 1 KAT NËNTOKË”,  
ME VENDNDODHJE NË SHËTITOREN BORSH, BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Z. Hito Lala, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë Shërbimi dhe Hotelerie 1 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në shëtitoren Borsh, Bashkinë Himarë, me zhvillues Z Hito Lala.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Himarë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI  
EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


**BELINDA BALLUKU**

A blue ink signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHqipërisë" at the top, "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the perimeter, and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

A blue ink signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHqipërisë" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" around the perimeter, and "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.